


Lumo Skendo

## **Disa dorëshkrime shqip me germa tyrqishte**

Besojmë se në Shqipëri do të ketë mjaft shkrime me germa tyrqishte, të shpëtuarë prej duhivet të ndryshme. Sa pa u-çdukur krejt, do të ishte mirë sikur të kujdesohëshim dhe t'i mështuellim, t'i kopiojmë në formët origjinale të tyre dhe duke i transkriptuarë.

Këndónjësuet të mij u lutem që t' i vënë re kësaj pike dhe do të jem fort i lumtur në më komunikofshin zbulimet dhe vërejtjet e tyre.

Në numur të parë, faqe 5 të kësaj reviste, bëmë fjalë për katër shkrime të Hafëz Ali Ulqinit, të cilët s'i kishim parë. Z Hamdi Bushati pati mirësinë të më siellë nga Leshi, ku ruhetë prej birit të ndyerit H. Ali, copat e para të tre dorëshkrimeve, dhe më ndihmoj në këndim të tyre.



Hafëz Ali Ulqinaku

I pari ka një format 18X23 santimetro, shkruarë bukur, pastrë dhe me dorë të Hafës Aliut; ftilon me afëro pësë faqe një parëthënëie arabishte, që po e përkthejmë më poshtë; pastaj vijnë afëro katër faqe tyrqishte në të cilat autori shpiegon alfabetin tyrqisht që ka adoptuarë për gjuhënë shqipe, dhe pas asaj vjen alfabeti vetë, që ka mbuluarë dy faqe e gjysmë.

Lënda vetë e librësë fillon në verso të fletës së shtattë, me titullin *Bedi-yl-mukattar*: është një mbledhje fjalësh dhe frazash tyrqishte të përkthyera shqip, e bërë me vjersha, me masë dhe kadencën që njihet në gjuhët orientale me quajtjen fa'datyn, mefa'ilyn, myfte'ilyn... Dorëshkrimi ka 191 faqe.

Ná këtú përkthimi, pakë shkurtuarë në funt, e parëthënjes arabishte:



„Gjuha shqipe ka mbetur e pa shkruarë dhe e pa përdorurë, dhe kështu, duke mos u-quajturë fare gjë, dukësh si e ngrirë dh' e vdekur midis gjuhëvet të tjera. Nuk i gjenj kësaj gjuhe no një të metë veç se kishte nevojë për ca shkronja dhe shënja. Shumë veta, dhe veçanërisht gra dhe kalamanjtë, i kam parë se jan' n'errësirë dhe s'kupëtojnë ç'u lipsetë, nga shkaku se nukë marrin vesh tyrqishtenë, dhe aqë më tepr' arabishtenë, veç se dëgjojnë disa vjersha, me masë dhe rimë, ose disa fjalë. Kështu u-shtrënguash që të përkthenj mevludin e pejgamberit: kjo ngjau kur isha në moshë të djalërisë; në mot 1290 u-mbarua, me lehtësinë që më dha Zoti fuqiplotë, mbreti i mbretërvet dhe dituri-math. Pastaj koha më shtyri, si qe shkruarë prej Zotit, qoft' i pastrë dhe i naltë, të ndahetë nga vëndi im, nga Ulqini dhe të vete në Shkodrë: më 1296. Disa miq që panë mevludin, kërkuanë që të përkthenj në vjersha mësimet të quajturë Hoda rabbim, të Ibrahim Hakkiut, bashkë me disa ngjarje dhe çashtje. E pranova urdhërin e naltë të tyre, i përktheva dhe i mëshatolla në një volym: viti më 1298. Edhe si u-shtyp morri famë në këtë qytet edhe në qytetet e tjerë, me lejën e Ministris' s' Arësimit, moti 1302.

„E gjeçë se, për Shqipëtarët, me tyrqishtenë, që është e lehtë dhe e vargënuhshme, munt të arrihetë qëllimi dhe dëshira e mësimet; po, takova disa nxanës nismëtorë që s'e kupëtonin mirë atë gjuhë, duke pasurë nevojë për një fjalor me shqipenë. Sa munda fillova të vjershëronj tyrqisht duke i përkthyerë shqip, që të lehtësonj kuptimin; moti ishte 1315; atje mblodha fjalët dhe nyjet që u duhenë për të folurë, sadoqë nuk është e mundurë t' i mëshatollë njeriu të gjitha. Ndoshta të kem lënë edhe shumë fjalë, po, me gjithë këtë, i cili dëshëron të mësojë tyrqishtenë prej shqipesë, mundet të bëjë një krahasim. Shpresohetë se munt të ketë edhe një tyrk që të dojë të nxërë shqipe, edhe e quajta *Bedi yl mukattar*. Si e mbarova, u-mentova dhe e pashë se nuk e plotëson qëllimin, nga shkaku se nukë gjen dot, ay që dëshëron, një fjalë nga tyrqisht, a në shqipet. Pra, disa prej miqvet më urdhëruanë të bënj një fjalor tjetër, duke e radhiturë pas shkronjavet të abecesë, që kësisoj të lehtësonetë kuptimi: unë, sa-dogë s'e pashë vetëhenë të zoti për këtë gjë, e pranova urdhërin e tyre, se, përulja përpara dëshirës së të mëdhenjet është një prej nevojavet të edukatësë, edhe atá që përulenë jan' në syt të mëshirës' së Zotit Porse gabuanë duke mejtuarë që unë jam i zoti, kur se kapitali im është fort i pakët, edhe nga pandehme e tyre unë jam fare lark; desha vetëm që t'i bindem urdhërit, edhe me gjithë që thashë se, i urdhënuimi nuk është më i ditun se urdhënuisi, fillova me ndihmën e ati që jep sukses për plotësim... Emnin ja ngjita *Axhib-yl-menzar*.... pastaj bëra një tjetër libër nga shqipeja në tyrqishtet, të cilën e quajta *Garib-yl-mebzar*; të parën në një libër, të dytën në tri, dhe të trija bashkë i quajta *Ulqin*, dhe kjo në kohë të sulltan Reshadit...“

Tani po japim edhe faqen e parë e *Bedi-yl-Mukattarit*:

*Allaha hamd* Zotit shyqyr, lëvdim *sena, derler* i thon,  
 Mahsus shyqyri, sana *ty*, ja rabbena *ej Zoti jon*,  
*verdi i dha, insana nír, dil* gjuh, *besar* t'pam, sem' nigjim,  
 ni' metleri *sajmak me njeft*, jokdër nihajet *s'kan marim*



*hakkën selami perenis, qoft olla, gjithëmon daima  
oll Ahmedi paqyzre përinini at Muhammed Mustafa  
.....i zot' turqënis  
ondan byjyq mâ i madh se aj, halk ollmamish s'ësht jeretis,  
pes mesanej, as-hable al ollsun selamllar qoft selam,  
allah zotyn, sulltanena mretit, ymr ihsan i dhasht,  
bir gjyni nji dit, bin nji mí, hak ejlesyn Zoti ja baft  
Hak hifz edé Zoti e rrujt, shen zemra mesruryl-fuad  
peq çok jasha fort shum rroft, mevl' el myluq Mehmed Reshad  
mystef' i lyn, bu bahre vezyn terezi  
çikdi i dolli tarihi menzumei arnaud*

1042 273

Po jap këtë një pjesë nga *copa* e fundit e broshurës që kam në dorë, nga fleta 11:

*gjylmeq me qesh, aghllamak me qá, aramak me kërku, jatmak me ra,  
jyr ec, otur rri, durmak me nenj, gjör shif, shiqá, kqyr, gjörmeq me pá,  
bakënëz shiqoni, gjelelëm pa vím, durunuz naloni, koshmak me ngá,  
japdëm e bana japajun e banj, japdëk e bamë, japmak me ba,  
japmish e ka bá, japaxhak e ban, jërtdëm e grisa, jarmak me ça;  
çardëm e thira, çarmak me thir, barmak me bërtit, sesle me zâ,  
hasta dejıldër nuk isht<sup>1</sup> i lik, bash aghrësë var, dhim kreje ka,  
sövdym e shava, sövdyk e sham, sövdyn e shave, sövmeq me sha.  
atdëm e hodha, atdi e hadh, asdëm e vorra, kurudu u-tha,  
jekadëm e lava, jëkadë e lau, jëkadëk e lamë, jëkamak me la,  
verexheqmi a jep, verërëm e jap, verelëm t'a japim, karzan uha....*

Dorëshkrimi i dytë i Hafëz Aliut ëshië gjithë në formatin e të parit, 18X23 santimetro, dhe i cili më thonë se ka 435 faqe; autori e ka titulluarë *Axhib-yl-Menzar*; çdo faqe është ndarë në dy shtylla, dhe çdo shtyllë prapë e ndarë me një vijë të hollë: në të parët është fjala tyrqisht, dhe në të dytët kuptimi i saj shqip; çdo faqe ka 22 gjer më 25 radhë, kështu që mban 44 gjer më 50 fjalë.

Po transkriptomë këtë të dy faqet e para të librësë :

<sup>1</sup> Të vërehetë forma *isht* e verbit *të qënë*, që përdor Ulqini



TYRQISHT	SHQËP
a	çud
a bumidir	çud a ky isht
ab	uj
abad	shen <sup>2</sup>
abad	gadí <sup>3</sup>
abamak	me i prit
abandërmak	me i u nalú
abanllamak	me hap hapin
abanmak	me i zavurrit
abanmak	me i key cipri
abanoz	kulumrí
abeni	sharavet
abdar	njom
abdar	ujë
abdall	budall
abdallëk	budallí
abdest	uj dursh
abrash	pedinaç
abru	uj ftyre
agha bej	ap <sup>4</sup>
ab gjine	poç
ablla	tad <sup>5</sup> ['dadë' A.M.]
abilak	ftyr mushun
ablloka	rethú
abli	skot
aburxhubur	çalapin
abuk sabuk	korr e mas lidh <sup>6</sup>
abona	përpara, peshin
abjarí	me lag
abjarí	unim
ap	fart <sup>7</sup>
ap ak	fart bardh
aparmak	me i pesú
aparmak	me i grabit
apaz	grusht
apaz bughdaj	një grusht grun

<sup>2</sup> 'abad' – duhet me u transkriptu si 'abat', fjalë e osmanishtes për 'i lumtun'. Hafëz Ali Ulqinaku e jep në shtyllën shqipe me një fjalë tjetër të turqishtes 'shen', 'i lumtun'. (Vër. A. M.)

<sup>3</sup> godi

<sup>4</sup> fjalë tyrqishte, shkurtim i *aghabej*, vëlla i math

<sup>5</sup> ? motr' e madhe. [Si duket, Lumo Skendo hutohet nga leximi i pakujdesshëm ose nga ndërnyshjet që imponon osmanishtja, sepse transkriptimi duhet me qenë 'dad(ë)' dhe jo 'tad', sepse 'dadë' don me thanë 'motër e madhe' në gegnishte. (Vër. A. M.)]

<sup>6</sup> që nuk di çë thotë

<sup>7</sup> Fort; autori shpesh përdor *a* në vënt të *o*: gadi, mas (godi, mos)...



apaz	pupo
apazllamak	me ec barka pupo
apazllamak	me bodërzhú
apansëz	në trështím
apallak	çilimi
apallak	kalama
apësh	tul koshe
apshak	shapullak
apshuk	prituc
apëshdërmak	me lodh shtancën <sup>8</sup>
apëshdërmak	me armëzhú barkën
apëshmak	me met krra
apëshëk	malís [molis]
apuk sapuk søjler	korr e mas lidh fiet
apull	llapash [llapaç]
apiko	kacavar
at	kal; hidh-e; qit
ata	bab; tat; át
atak	qitun
atak	hiedhun
atakllëk	përhiedhun
atan	yt át, baba jat
atana	t'yt ét, babës tan
atanë	t' t'at, babën tan
atallar	baba
atallarë	babat
atam	em at, baba jem
atama	t'im ét, babës t'em
ataja	babës
atdërmak	me i bá me qit
atdërmak	me i bá me hiedh
aterina <sup>9</sup>	cumr
atesh	zjerm
atesh byxheji	xhixhllonj
ateshpare	gac <sup>10</sup>
ateshpare	shkuní <sup>11</sup>
ateshperest	taptisun zjarmit
ateshçi	zjermur
ateshzeban	gjuh zjerm
ateshzeban	therc

<sup>8</sup> lodh – asht ose gabim shtypi, ose keqlexim i 'hodh' dmth. 'me hodhë shtancën (spirancën?)' (Vër. A. M.)

<sup>9</sup> kamus tyrqi fjalës aterina i jep kësi kuptimi: një farë peshku, merxhan ballëk, i madh. [Në shqip fjala asht për lloj peshku që quhet 'cumër, - Lloj qefulli me trup boshtor e të zhdërvjellët, qefulli i verës,' gushtak.' FGjSSh. 1980. (Vër. A. M.)]

<sup>10</sup> me kall, me kath, të ndezur; kallës, kádhës, gac: që ndez, një copë zjar.

<sup>11</sup> shkuní dial. për shkëndijë (vër. A. M.)



ateshgjözy	gac zjarmit
ateshler	zjarminje
ateshlik	votr
ateshlendirmeq	me i dhan zjerm

Dorëshkrimi i tretë është gjithë n'atë format dhe me até shkrim të pastrë si edhe dy të parët; çdo faqe është ndarë, si edhe i pari, në dy shtylla, dhe çdo shtyllë në dy pjesë; faqetë kanë 21-23 radhë, dhe janë, pas informatavet që më jipte z. Hafëz Said, 133 faqe. Titullin e ka *Ganb-yl-Mebsar*.

Të dy faqet e para mbajnë këto fjalë :

SHQIP	TYRQISHT
a	öjlemi
abarr <sup>12</sup>	avlli
abarra	avllëllar
abard <sup>13</sup>	ÿryÿsh
abic <sup>14</sup>	kapún
abica <sup>15</sup>	kapunllar
ap	a' bej
apan <sup>16</sup>	çarëk
apana <sup>17</sup>	çarëkllar
apët	prap
aposta	mahsus
apifa [?]	sallpa [?] <sup>18</sup>
apín	çarëk
apína	çarëkllar
atë	ata, peder
atá	onllar
atypari <sup>19</sup>	orallë
atyne	onllara
atë	onu
atí	oná
atje	orada
axh	amuxha
axha	amuxhallar
axharr	kallaballëk

<sup>12</sup> Shënuam' më lart përdorimin e *a* në të *o*; pra abarr: obor; më poshtë edhe autori shkron aborra.

<sup>13</sup> ? tyrqishtja ka kuptimin: ecje.

<sup>14</sup> as shqipeia, as tyrqishtja nuk' kupëtohetë [Duhet të transkriptohe si 'abic(ë)' e jo 'abie' qysh ka dalë, sepse shumësi del në fjalën e radhës 'abica'. Sipas turqishtes 'kapun, kapunllar' del me qenë 'qepen, ~at' (vër. A.M.)]

<sup>15</sup> as shqipeia, as tyrqishtja nuk' kupëtohetë

<sup>16</sup> do me thënë: opanga, opinga.

<sup>17</sup> do me thënë: opanga, opinga.

<sup>18</sup> salpa – në tyrqishte '1. i labërguem; leshko; dembel; 2. Lloj gjallesash deti' (vër. A. M.)

<sup>19</sup> në folje të Shkodrës *atypari* do të thotë nga ajo anë.



ad	adá
ar	klaptan
ar	tarllá
arç [?]	qevezit [?] <sup>20</sup>
ardh	gjelish
ardhun	jakëshëk
ardhí	asmá
ardhí rrushit	yzym asma
ardhija	asmallar
ariz	pirinç
arsy	xhevap
argun [?]	byxhyrgat [?] <sup>21</sup>
ark	sandëk
arkec	tarem tak
arm	silah
armatís	silahllanma
armaç	jërtmaç
armuz [?] <sup>22</sup>	sokra [?]
armish	armador
arn	jama
arna	jamallar
arnim	jamallëk
arnumun	jamanmësh
ariz	pirinç
arr	xheviz
arra	xhevizler
arrç	qevezit <sup>23</sup> ['gjevezit' A.M.]
a rri	otururmu
a rri	otururmujum
a rrihet	oturullurmu
asaj	ona
aspak	hiç
ashpër	sert
asht	qemiq
ashtu	öjle
ashtu isht	öjledër
ashkël	jonga
ashkla	jongallar
ashik	bixhil
agzat	jemliq

<sup>20</sup> Kjo fjalë asht dhanë dy herë. Një herë si 'arç' e masandej si 'arrç'. Por në turqishte del njësoj 'qevezit'. Shih fusnotën 23. (Vër. A. M.)

<sup>21</sup> Në turqishte 'bucurgat' asht fjalë e vjetër që asht përdorë për 'vinç' (vër. A. M.)

<sup>22</sup> 'armuz', në turqishte, boshllëk ndërmjet kuvertës dhe anës së barkave prej druni. (Vër. A. M.)

<sup>23</sup> Si duket keqlexim nga Lumo Skendo i fjalës 'qevezit' (jo 'qevezit' ndoshta 'gjevezit') dmth. kandërr e ngjashme me bulkthin, quhet edhe *bushtërz, këlysh dheu*. (Vër. A. M.)



agiç	qysmen
afër	jakën
afro	janash
afiq *	llagap <sup>24</sup>
a ka	varmi ?
akull	buz
akoma	dahá
anth	basan: qabus
anc	belbel
anër	ru'ja
anej	q»é
alka	kajmak
allagrap	akën
ám	mexhra

\*

Përveç këtyre tre dorëshkrirneve të Haffz Aliut, në Shkodrë gjenden edhe disa shkrime shqip të tjerë, të mbeturë nga kohë të ndryshme, dhe prej të cilëve Z. Shevqet Muka pati mirësinë të më bjerë katër copë, të gjithë të shkruarë me germa tyrqishte.

Tefteri i parë është në format të vogël, me 12 fletë do me thënë 22 faqe, në vjersha: është ajo librë fetare që quhet *Emni Véhbié*, shkruarë prej Tahir efendi Jakovës, i njohurë me emër Tahír efendi i math. Në funt të faqesë 21 këndojmë këtó radhë:

„Seneja nji mij e dy qint e njizet e nji „tamam u-bë Vehbie, kur Zoti má dha hedië“

Libra e dytë ka një format 15,5X20 santimetro, dhe mban 190 faqe; autori i saj është Mulla Ramadan Shkodra, i njohurë me emër Mulla Rama, hoxhë në Postripë. Tefteri është ndarë në disa pjesë:

6 faqe në krye, në vjershë, janë *Ilm-i-hal*, të cilat i vazhdojnë katër faqe prozë, edhe kështú, herë me vjershë dhe herë me prozë vete gjer në faqe 73.

Pjesa e dytë quhetë *Risale-i-Sufie*, në vjershë, nga faqe 74 gjer më 86.

Vijnë pastaj 9 faqe në prozë, një landë fetare dhe këtó i pason pjesa e madhe në vjershë, e quajturë *Nasihát-yd-din fi hífz-il-lisan*, pjesë që vete gjer në funt të tefterit, me tri ilahi në mbarim.

Transkriptojmë këtú copën e parë të kësaj pjese së madhe, faqetë 96, 97, 98 të tefterit :

Bismil-lahi une po tham,  
me fol qitabin nnim të kam;  
ëlhamdy lil-lahi po tham

<sup>24</sup> fjala asht për 'ofiç' (Vër. A. M.)



qi më ke fal ehli islam,  
me ke falun me din e iman;  
ibadet baj un Zotit t'an  
shyqyr me të bamun gjithkú mmar  
nuk dí ku filloj mâ par:  
me fillú në kry ç'ka jan  
shyqyrin s'munt t'a baj taman;  
johse a'zadeve të tán  
po ni' meteve qi m'ke dhan!  
Gjithkun une i mangut jam  
veç ti, ej Zot, qi je tamam  
me sifate temam ti je  
pej t'mangunash mynezzeh je.  
Për me t'qen dú me diftú  
tok e qiellna i ke rreshtú  
une e di, ej Zot, qi je një  
perpara njihit s'âsht kurnji  
as ka venn Zoti mí qillna,  
as ka n'tok, kshtu e dim na.  
Nuk ash një senn sikur Zoti  
delile jan edhe me mij,  
ajetit veni mennen ti:  
të tham: *Lejse qemithlihi.*  
Sikur se duhet me e diftú  
nuk' âsht mymqyn për me kallxú  
këta alamete qi ka dhan  
turk e bull për me i prú iman.

Për të dhënë një kuptim nga ilm-i-hali po japitn edhe prej atij katrë vjersha qitun nga faqeja 27:

Hem shehadetin n'e pâr e der n'e mram  
me than me goj, me zemr, xen bes temam;



edhe ma'nan shehadetit për m' e xán

kush të jet turk edhe bull<sup>25</sup> farz e kan

Në faqe 55 dhe 183 të dorëshkrimit këndojmë këtë dy copë që rrëfejnë influencën e Tahir efendi Jakovës dhe, në sa respekt të math ka qënë në Shkodrë, sikundër që përmendet edhe Haxhi Hasan efendiu që paska kënduarë shqip hytbenë :

„Tahir efendis borxh e kena me i bá dua fort. Pernija e past bâ ehli xhennet, në derexhe të nalt. Edhe kusuret já falt, pak a shum në past, qi e vuri shqiptoren në kalem. Gjithkush e flet, plak e i ri, dinin edhe imanin po merr vesht“.

„Zoti já falt Tahir efendis gjynahet e tij, edhe' i dháshtë rahmet me miluj edhe me mij, qi na bani shqipen ixhad me kalem, e po xen plak e i ri; edhe past rahmet sa rana n'det nj'aj qi rri n'xhamí të Kara Hasan, qi emnit i thon elhaxhi Hasan efendi, qi na forcoj dinin shqip në hytbe, hem kudó qi po rri. Edbe Zoti e falt q'at hoxh katunsh, hem gjá s'di, se ka gjynahe qi s'i xan kál, as qerr, as gjemi, edhe mâ shum së ka deti ran, e në dynja bar e gjeth. I mjeri i bâj rixha hallkut m'ket zeman nji el-hamd të ma kënoni; johsa bari pa nji rahmet mos të m'leni.

Bashkë me këta dy dorëshkrime.më prunë nga Shkodra edhe tre të tjerë; po këta ishinë vetëm kopie të copëvet të Mulla Ramës, dhe kështú nukë peraqitin për neve no një gjë të re.

*Marrë nga revista 'Diturija' e Lumo Skendos*

*Përgatiti për botim me disa vërejtje shtesë rreth transkriptimit: Agim Morina.*

---

<sup>25</sup> Bull grua myslimane; veç Shkodrësë këtë fjale e gjejmë edhe në Janinë, të përdorur' edhe kur fjasinë greqisht. Mbase nga shqipeja: *e mbulume*. [Asht fjala për grue myslimane, 'bullë, ~a'. (Vër. A. M.)]